



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Abnid" Sh.P.K. të datës 31.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 26.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ofrimi i shërbimeve për mobilitet (Lot 1 dhe Lot 2)" me nr. të prokurimit 616-23-6444-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Abnid" Sh.P.K. të datës 31.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 26.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ofrimi i shërbimeve për mobilitet (Lot 1 dhe Lot 2)" me nr. të prokurimit 616-23-6444-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Abnid" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Abnid" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 31.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 26.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ofrimi i shërbimeve për mobilitet (Lot 1 dhe Lot 2)" me nr. të prokurimit 616-23-6444-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): "AK kishte kërkuar në FDT që OE të kenë projekte të realizuara në tre vitet e fundit dhe atë vlerën 300,000.00€ vetëm për një Lot. Këtë kriter nuk ka arritur t'a plotësoj Grupi i OE të shpallur fitues sepse vlera e projekteve të paraqitura nuk e arrin shumën që të mbuloj të dy Lot-et për të cilat ka aplikuar".

Pretendimi i dytë (II): "AK kishte kërkuar autorizimin e prodhuesit për Radar dhe Bluetooth. Grupi i OE i shpallur fitues nuk kishte arritur të e plotësoj këtë kërkesë sepse autorizimi i tillë nuk është për të dy llojet e pajisjeve të kërkuara. GOE në fjalë kishte dorëzuar dëshmi se kompania e tillë autorizuese prodhon pajisjet Radar por jo edhe pajisjet Bluetooth për mbledhjen e të dhënave".

Pretendimi i tretë (III): "AK kishte kërkuar që OE të kenë software bashkëkohore për analizë dhe studim të rrjetit e cila duhej dëshmohej me faturë të blerjes. GOE nuk e kishte paraqitur fillimisht dëshminë e posedimit të softwareve të tilla andaj AK i ka kërkuar sqarim shtesë. Sqarimi i tillë nuk mundet të kërkohet për dëshmitë tilla siç janë faturat e blerjes sepse si të tilla ato munden edhe të modifikohen pra nuk janë dëshmi objektivisht të verifikueshme".

Pretendimi i katërt (IV): "Grupi i OE nuk ka arritur të dorëzoj dëshmi të mjaftueshme sepse nuk ka paraqitur asnjë të dhenë tek katalogjet e ofruara për pajisjet Bluetooth që shërbejnë për mbledhjen e të dhënave".

Pretendimi i pestë (V): "AK në kuadër të kërkesave mbi mundësit teknike dhe profesionale kishte kërkuar që OE të jenë të pajisur me certifikata ISO. Grupi i OE kishte paraqitur certifikatat e tilla por ato ishin paraqitur vetëm për njërin nga anëtarët e konzorciumit dhe duke u bazuar në nenin 26.6 të RRPP plotësimi i këtij kushti ka dështuar çka e bënë grupin e tillë të papërgjegjshëm".

Pretendimi i gjashtë (VI): "AK kishte kërkuar që OE të jenë të pajisur me staf profesional. Grupi i OE nuk ka artitur të i dorëzoj të gjitha dëshmitë e kërkuara për ekspertin e parë dhe të tretë dhe AK më vonë gjatë vlerësimit i ka kërkuar sqarim të tenderit. Me rastin e sqarimit të tenderit Grupi i OE në fjalë kishte dorëzuar dëshmi që posedojnë datën më të vonshme se sa data e hapjes publike të cilat nuk mund të pranohen si dëshmi të rregullta për qëllimin e dorëzuar. Fjala është për referencën e z. Modest Gashi e cila është lëshuar me datën 16.10.2023 ndërsa hapja publike ka qenë me datë 21.08.2023. Referenca e tillë konsiderohet plotësim substancial i tenderit dhe sipas nenit 59.4 si dhe sipas nenit 72 të LPP është e papranueshme".

Lidhur me pretendimin të parë (I), të dytë (II) të tretë (III) dhe të katërt (IV) ankimor, janë administruar të gjitha dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar si dhe të njëjtat janë krahasuar në raport me kërkesat përkatëse të dosjes së tenderit por edhe në raport me raportin e komisionit për vlerësimin e tenderëve. Me këtë rast është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesit sipas të cilit tenderuesi nuk ka dëshmuar kontrata në vlerë mbi 300,000.00 euro për secilin lot është pretendim i pabazuar. Kjo për arsye se nga dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar por edhe nga raporti i komisionit vlerësues është evidentuar lista e kontratave së bashku me dëshmitë dokumentare përcjellëse (referencat, etj) me të cilat është dëshmuar se tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur edhe këtë kriter në përputhje të plotë me dosjen e tenderit. Rrjedhimisht pretendimi i parë ankimor është i pabazuar në tërësi.

Ngjashëm edhe sa i përket pretendimit të dytë të parashtruesit sipas të cilit tenderuesi i rekomanduar nuk e ka dorëzuar autorizimin për radar dhe bluetooth është pretendim i pabazuar. Kjo për arsye se nga dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar por edhe nga raporti i komisionit vlerësues është evidentuar autorizimi në fjalë me të cilin është dëshmuar se tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur edhe këtë kriter në përputhje të plotë me dosjen e tenderit. Rrjedhimisht edhe pretendimi i dytë ankimor është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pretendimit të tretë duhet cekur se për parashtruesin nuk është fare kontestues fakti që tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur kërkesën përkatëse sipas dosjes së tenderit. Për parashtruesin është kontestues vetëm fakti nëse ka autoriteti kontraktues ka pasur të drejtë që të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Me këtë rast duhet sqaruar se sqarimet janë kërkuar në përputhje të plotë me nenin 72 ku përcaktohet se *“Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”*. Përndryshe mënyra si janë kërkuar sqarimet është bazuar tërësisht në pikën nr. 10 të UPP. Prandaj edhe pretendimi i tretë ankimor është i pabazuar në tërësi.

Po ashtu edhe pretendimi i katërt ankimor sipas të cilit tenderuesi i rekomanduar nuk i ka dorëzuar katalogjet sikurse janë kërkuar me dosjen e tenderit është pretendim i pabazuar. Kjo për arsye se nga dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar por edhe nga raporti i komisionit vlerësues është evidentuar dorëzimi i katalogjeve në fjalë me të cilin është dëshmuar se tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur edhe këtë kriter në përputhje të plotë me dosjen e tenderit. Rrjedhimisht edhe pretendimi i katërt ankimor është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e pestë (V) ankimor duhet sqaruar se për parashtruesin nuk është fare kontestues fakti që lideri i tenderuesit të rekomanduar i ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas dosjes së tenderit dhe në emër të grupit të operatorëve ekonomik. Megjithatë për parashtruesin është kontestues vetëm fakti nëse të njëjtat dëshmi dokumentare është dashur që të dorëzohen dy (2) herë respektivisht edhe për anëtarin tjetër të grupit të operatorëve ekonomik. Përmes nenit 71 paragrafit 4 të LPP është përcaktuar se *“Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”*. Në rastin konkret kjo kërkesë e dosjes së tenderit i referohet nenit 69 të LPP dhe rrjedhimisht aplikohet vetëm nga grupit si tërësi dhe jo ndaj secilit anëtar individualisht. Prandaj pretendimi i pesët (V) ankimor është në tërësi i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e gjashtë (VI) ankimor duhet sqaruar se dëshmitë dokumentare për kërkesën e dosjes së tenderit për të cilën bëhe fjalë është *“cv, diploma, certifikata, kontrata e punës dhe referencat për përvojën e punës”*. Ndërsa përvoja e punës së kërkuar për ekspertin në fjalë sipas dosjes së tenderit është min. 7 vite. Fillimisht duhet cekur se ky pretendim është jorelevant sepse hipotetikisht edhe nëse pretendimi do të ishte i bazuar (që nuk është aspak), përmes dëshmimeve dokumentare të dorëzuara është

dëshmuar se eksperti në fjalë i ka mbi 7 vite përvojë të punës edhe pa këtë referencë. Sidoqoftë duhet theksuar faktin që për parashtruesin nuk është kontestuese përvoja e punës që nënkupton se parashtruesi nuk e konteston faktin se punët janë kryer nga eksperti sikurse thuhet në referencën e kontestuar. Rrjedhimisht nuk kontestohet as përvoja e tij e punës. Për parashtruesin është kontestues vetëm nëse data në referencë është e pranueshme ose jo. Me këtë rast duhet cekur se kjo referencë është dorëzuar sipas sqarimeve të kërkuara. Rrjedhimisht pretendimi është i pabazuar tërësisht.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.11.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.